



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave

V E N D I M

Nr. 666 , datë 26.10.2005

PËR

DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.459, DATË 23.9.1999, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KRIJIMIN E KOMITETIT
SHTETËROR PËR KULTET", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 10 e 100 të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", dhe të neneve 124 e 128, të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.459, datë 23.9.1999, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

1. Paragrafi i dytë, i pikës 1, ndryshohet si më poshtë vijon:

"Komiteti Shtetëror për Kultet është institucion qendror, person juridik, në varësi të ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve."

2. Paragrafi i parë, i pikës 2, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Komiteti Shtetëror për Kultet ka përgjegjësitë e mëposhtme:”.


3. Pika 3 ndryshohet si më poshtë vijon:

“3. Komiteti Shtetëror për Kultet përbëhet nga kryetari dhe katër anëtarë. Kryetari i Komitetit Shtetëror për Kultet dhe anëtarët e këtij komiteti, të cilët propozohen nga kryetari, emërohen nga ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Për emërimin e përbërjes së Komitetit Shtetëror për Kultet, ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe kryetari i tij marrin parasysh dhe ruajnë parimet e asnjësisë shtetërore dhe të barazisë së bashkësive fetare, si dhe faktin, që struktura e komitetit, të reflektojë realisht identitetin dhe vlerat e bashkësive fetare.

Struktura, organika dhe rregullorja e veprimtarisë së Komitetit Shtetëror për Kultet miratohen nga Kryeministri, me propozimin e ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.


KRYEMINISTRI



SALI BERISHA

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ILIR RUSMALI



“Komiteti Shtetëror për Kultet ka përgjegjësitë e mëposhtme:”.


3. Pika 3 ndryshohet si më poshtë vijon:

“3. Komiteti Shtetëror për Kultet përbëhet nga kryetari dhe katër anëtarë. Kryetari i Komitetit Shtetëror për Kultet dhe anëtarët e këtij komiteti, të cilët propozohen nga kryetari, emërohen nga ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Për emërimin e përbërjes së Komitetit Shtetëror për Kultet, ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe kryetari i tij marrin parasysh dhe ruajnë parimet e asnjësisë shtetërore dhe të barazisë së bashkësive fetare, si dhe faktin, që struktura e komitetit, të reflektojë realisht identitetin dhe vlerat e bashkësive fetare.

Struktura, organika dhe rregullorja e veprimtarisë së Komitetit Shtetëror për Kultet miratohen nga Kryeministri, me propozimin e ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI



SALI BERISHA

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ILIR RUSMALI

